

VENDIM
Nr. 91, datë 28.7.2020

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME BULQIZË SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”(VKM-ja nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.7.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Sektori Juridik mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. për licencim,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë (UK Bulqizë), me shkresën nr. 339 prot., datë 16.7.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Bulqizë, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) UK Bulqizë ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar, për shkak të riorganizimit të shoqërisë sipas parashikimeve të VKM-së nr. 63;

b) Shoqëria UK Bulqizë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 41,628 banorë në Bashkinë Bulqizë;

c) Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Bulqizë sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Bulqizë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Bulqizë, rekomandon:

- Shoqëria UK Bulqizë duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave të largimit të ujërave të ndotura, shërbim të cilin se kanë pasur më parë.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Bulqizë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. me NUIS: J66702422U, në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor: Asllan Daxha;
 - b) Drejtues Teknik: Fisnik Hyseni.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. është Bashkia Bulqizë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani